

UDHËZIM
Nr.5, datë 13.2.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 3.2.2010 TË MINISTRIT TË
ARSIMIT DHE SHKENCËS “PËR NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR DHE STANDARDE TË LIDHURA ME TO”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 64 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në germën “a” të pikës 2 të kreut II, ngarkesa mësimore e mësuesit të gjuhës shqipe dhe leximit letrar, nga 22 orë bëhet 20 orë.

2. Pas germës “a” të pikës 2 të kreut III, të shtohet germa “a/1”, me tekst: “Mësuesi i letërsisë...20 orë në javë”.

3. Teksti i pikës “c” të kreut IV “Norma të veçanta”, të zëvendësohet me tekstin në vijim: “Kryetarit të sindikatës së arsimit në një rreth, në varësi të numrit të anëtarësisë me kuotizacion, t’i ulet norma nga 5 deri në 10 orë në javë. Në seksionet e qarqeve, që kanë më shumë se 600 anëtarë, i reduktohet norma mësimore javore me 6-8 orë edhe një personi të dytë”.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj